

# Asylum Advice

Pas vendimeve  
- Refuzimi



# Section 4B:

## Pas vendimeve - Refuzimi

Kjo pjesë shpjegon se çfarë ndodh nëse aplikimi juaj refuzohet.

Nëse keni pyetje që janë specifike për kërkesën tuaj për azil ju duhet t'i ngrini ato me këshilltarin tuaj ligjor i cili do të mund t'ju japë këshilla.

### 4B.1 Opsionet që keni pas një refuzimi

Pas intervistës tuaj për azil, Home Office mund të vendosë që t'jua refuzojë kërkesën tuaj për azil. Ju mund të keni të drejtën të apeloni ndaj vendimit të Home Office. Nëse Home Office e refuzon kërkesën tuaj do t'ju japë një letër në të cilën paraqiten arsyet. Letra do të jetë shkruar në anglisht dhe ju duhet ta diskutoni përmbajtjen e saj me këshilltarin tuaj ligjor nëse nevojitet. Letra do të konfirmojë përse Home Office mendon se ju nuk i përmbushni arsyet për azil ose mbrojtje humanitare. Ju duhet t'i konsideroni me kujdes opsionet tuaj në këtë fazë:

Ju keni opsionet e mëposhtme:

- Mund të keni të drejtën të apeloni ndaj vendimit të Home Office. Kjo do të thotë se ju mund t'i kërkonti një gjykatësi të imigracionit, i cili është i pavarur nga Home Office, ta shqyrtojë vendimin dhe të vendosë nëse ata janë dakord me të. Këtë duhet ta diskutoni me këshilltarin tuaj ligjor. Ju lutemi vini re se ka kufizime kohore për apelin kundër vendimit të Home Office.
- Nëse merrni një “refuzim të certifikuar” kjo do të thotë se nuk e keni të drejtën automatike që të apeloni. Megjithatë mundet që të aplikoni për një Rishikim Gjyqësor. Këtë duhet ta diskutoni me këshilltarin tuaj ligjor. Këshilltari juaj ligjor mund të aplikojë për një Rishikim Gjyqësor nëse ka arsye për ta bërë këtë.
- Nëse nuk dëshironi të apeloni atëherë skema e Kthimit Vullnetar të Asistuar (AVR) është mënyra më e përshtatshme për t'u larguar nga Mbretëria e Bashkuar. Skema AVR menaxhohet nga Home Office, ju lutem shihni: [www.gov.uk/return-home-voluntarily](http://www.gov.uk/return-home-voluntarily)

Për informacion të mëtejshëm kontaktoni:

[www.gov.uk/return-home-voluntarily](http://www.gov.uk/return-home-voluntarily)

Departamenti i nisjes vullnetare: 0300 004 0202

## 4B.2 Nëse zgjidhni të apeloni

Nëse çështja juaj refuzohet nga Home Office dhe ju zgjidhni të përdorni të drejtën për të apeluar, mund t'ju duhet të kontaktoni këshilltarin tuaj ligjor menjëherë pasi të keni marrë njoftimin se kërkesa juaj është refuzuar. Ata duhet të organizojnë një takim me ju për të diskutuar refuzimin tuaj dhe për të përcaktuar arsyet e apelit. Që një këshilltar ligjor t'ju përfaqësojë nën ndihmën ligjore (që ndihmon me kostot e këshillave ligjore) duhet të tregoni se keni të ardhura të ulëta dhe se çështja juaj ka një mundësi reale që të dalë me sukses. Kjo do të thotë se ndihma ligjore do të jepet vetëm nëse çështja juaj ka një mundësi prej 50% ose më shumë që të dalë me sukses. Këshilltari juaj ligjor do të plotësojë një test të meritës për të përcaktuar situatën. Nëse nuk e kaloni testin e meritës do t'ju refuzohet ndihma ligjore.

## 4B.3 Çfarë ndodh nëse më refuzohet ndihma ligjore?

Ju ose këshilltari juaj ligjor mund të kërkonin që refuzimi i ndihmës ligjore të shqyrtohet sërish. Ju lutemi pyesni këshilltarin tuaj ligjor rreth apelimit dhe refuzimit të ndihmës ligjore.

Nëse nuk jeni në gjendje të merrni ndihmë ligjore dhe këshilltari juaj ligjor mund të punojë privatisht për ju, do t'ju duhet të paguani për këto këshilla ligjore. Ata duhet t'ju shpjegojnë dhe ju duhet të bini dakord me kushtet e tyre të biznesit përpara se ata të mund të fillojnë të punojnë për ju privatisht.

Nëse ju refuzohet ndihma ligjore dhe nuk mund të paguani për këshilla ligjore, mund të përfaqësoheni vetë nëse dëshironi.

## 4B.4 Dëgjimi i apelit

Seancat e dëgjimit të apelit kryhet në Asylum Immigration Tribunal (AIT). Pasi të jetë dorëzuar apeli do të njoftoheni se në cilën gjykatë do shqyrtohet çështja. Ka dy gjykata, First-Tier Tribunal dhe Upper Tribunal. Në secilën prej tyre ka dhoma të imigracionit dhe azilit. Në Mbretërinë e Bashkuar ka një numër gjykatash. Roli i First-tier Tribunal është që të dëgjojë dhe të vendosë mbi apelet kundër vendimeve që janë marrë nga Home Office.

Pasi të jetë caktuar data e dëgjimit të apelit tuaj, do të merrni një letër konfirmimi me datën, orën dhe vendin se ku do të kryhet seanca e dëgjimit. Nëse mbështeteni nga Home Office atëherë mund të aplikoni për bileta udhëtimi. Ju duhet të dërgoni një kopje të letrës tuaj për seancën e dëgjimit dhe një kërkesë për bileta. Këtë duhet ta bëni sa më parë që të jetë e mundur. Asylum Help mund t'ju ndihmojë ta bëni këtë. Ju lutemi kontaktoni 0808 800 620 nëse keni nevojë për ndihmë me këtë.

Një Asylum Immigration Tribunal (AIT) mund të vendosë (në çdo kohë përpara dëgjimit të zgjeruar) se çështjet e ngritura në një çështje të veçantë janë komplekse dhe për këtë arsye mund të udhëzojë që çështja të dëgjohej nga një Panel Imigracioni ose një Gjykatës i Lartë i Imigracionit.

Është e rëndësishme që ju të mbërrini të paktën 30 minuta përpara seancës tuaj në qendrën e dëgjimit të apeleve. Aty ju do t'ju bëhet kontrolli dhe do të mësoni se në cilën dhomë do të dëgjohej çështja tuaj. Gjatë seancës mund të shihni se në dhomë janë personat në vijim:

- Gjykatësi i imigracionit: ata ulen në krye të dhomës në një platformë të ngritur. Ata drejtojnë seancën dhe kanë të ngjarë t'ju bëjnë pyetje rreth çështjes tuaj ju, këshilltarit tuaj ligjor dhe oficerit përfaqësues të Home Office.
- Oficeri përfaqësues i Home Office: mundet që Home Office të ketë një përfaqësues që përfaqëson anën e tyre në çështjen tuaj dhe që mbron arsyet përse nuk ju është dhënë leje qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar.
- Dëshmitarët: çdo dëshmitar i thirrur për të dhënë evidencë në çështjen tuaj.
- Përkthyesi i gjykatës: nëse keni kërkuar një përkthyes ose përkthyesë atëherë ata do të përkthejnë çdo pyetje që ju bën gjykatësi dhe do të përkthejnë përgjigjet tuaja. Ata duhet të përkthejnë saktë atë që thuhet në mënyrë që Home Office të ketë një transkript të plotë të informacionit që jepni.

Përkthyesve ju kërkohet që çdo informacion që jepni ta mbajnë rreptësisht konfidencial. Nëse keni ndonjë shqetësim rreth përkthyesit apo përkthyeses tuaj ose nuk e kuptoni mirë aksentin ose dialektin e tyre duhet që këtë çështje ta ngrini sa më parë që të jetë e mundur me këshilltarin tuaj ligjor dhe gjykatësin e imigracionit. Kjo nuk do të ndikojë mbi vendimin ose rezultatin e çështjes tuaj.

Sallat e gjykatës janë vende publike ndaj mund të ketë edhe persona të tjerë në të.

## 4B.5 Shtyrjet

Mund të bëhet një kërkesë për shtyrje te AIT nga ju ose këshilltari juaj ligjor në çdo kohë pasi të jetë caktuar data e seancës dëgjimore dhe përpara datës së seancës dëgjimore. Kërkesa mund të bëhet te Case Management Review Hearing. Ju ose përfaqësuesi juaj ligjor mund të argumentoni se ju nevojitet më shumë kohë për të marrë evidencë që të mbështesni apelin tuaj (si për shembull raporte mjekësore ose dokumente nga jashtë).

Gjykatësi, Home Office ose këshilltari juaj ligjor mund të kërkojnë një shtyrje nëse shfaqet ndonjë problem gjatë dëgjimit të apelit tuaj që kërkon hetime të mëtejshme.

Nëse keni dokumente në vendin tuaj që mendoni se janë të rëndësishme, duhet ta

diskutoni këtë me këshilltarin tuaj ligjor sa më parë që të jetë e mundur. Mundet që shqyrtimi i kërkesës tuaj të shtyhet ndërkohë që ju organizoni që t'ju dërgohen këto dokumente, nëse nuk ka rrezik për ju ose familjen tuaj që ta bëni këtë.

Nëse gjykatësi vendos ta shtyjë seancën duhet të jepet një datë tjetër. Data nuk duhet të jetë më shumë se 28 ditë pas datës origjinale të seancës dëgjimore përveçse kur ka rrethana të jashtëzakonshme.

Gjykatësi mund të vendosë të mos e shtyjë seancën dëgjimore dhe ju duhet të paraqiteni në gjyq. Nëse nuk paraqiteni, çështja juaj mund të vendoset edhe pa praninë tuaj.

## 4B.6 Gjatë dëgjimit të apelit

Ju duhet t'i përgjigjeni pyetjeve të gjykatësit me sa më shumë informacion që mundeni të jepni. Gjykatësi, këshilltari juaj ligjor dhe përfaqësuesi i Home Office mund të diskutojnë se si zbatohet ligji në rastin tuaj.

Mund të mos doni të flisni rreth disa çështjeve, veçanërisht për çështje personale ose të ndjeshme, por këto çështje që shpesh janë shumë të vështira për të diskutuar mund të jenë thelbësore për të përcaktuar kërkesën tuaj. I gjithë informacioni që mund të jepni e ndihmon gjykatësin që të kuptojë më mirë arsyet tuaja për të kërkuar mbrojtje.

Është thelbësore që ju të tregoni të vërtetën dhe të jepni sa më shumë informacion që të jetë e mundur rreth asaj që ju ka ndodhur dhe përse ju duhet mbrojtje.

Mund të mos e mësoni vendimin që ka marrë gjykatësi menjëherë pasi të ketë mbaruar seanca. Gjykatësi do t'i marrë dokumentet tuaja me vete dhe do ta shqyrtojë çështjen e pastaj do të marrë vendimin. Vendimi më pas do t'ju dërgohet ju.

Gjykatësi do ta shqyrtojë apelin tuaj për azil duke aplikuar 'Konventën e Refugjatëve' dhe 'Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut' mbi rrethanat individuale të kërkesës tuaj. Ata do të shikojnë nëse keni arsye për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar.

Gjykatësi do t'ju dërgojë si ju (dhe këshilltarit tuaj ligjor) ashtu dhe Home Office një kopje të përcaktimit (vendimit). Përcaktimi do të konfirmojë nëse gjykatësi mendon se ju i plotësoni kriteret për leje qëndrimi. Ata ose do ta pranojnë ose do ta refuzojnë apelin tuaj. Përcaktimi do të përfshijë arsyetimin për vendimin e gjykatësit.

## 4B.7 Pasi të jetë marrë vendimi

Në disa rrethana të caktuara si ju ashtu dhe Home Office do të mund të apelonit. Nëse jeni në Mbretërinë e Bashkuar, afati kohor është 10 ditë, nëse jeni në ndalim afati i

apelit është 5 ditë dhe nëse jeni jashtë Mbretërisë së Bashkuar afati kohor është 28 ditë. Aplikimi për leje që të apelonit duhet bërë Upper Tribunal i Asylum Immigration Tribunal. Në këtë fazë ju ose Home Office do t'ju jepet leje për të apeluar vetëm nëse ka arsye për të provuar se nuk është ndjekur ligji gjatë shqyrtimit të çështjes tuaj.

Në Angli Upper Tribunal (Immigration and Asylum Chamber) shqyrton:

- apelet ndaj vendimeve të marra nga Gjykata e Shkallës së parë në çështjet e imigracionit, azilit e shtetësisë dhe;
- disa rishikime gjyqësore (imigracioni).

Në Skoci çështja juaj mund të paraqitet përpara Court of Sessions.

Në Irlandën e Veriut kjo do të bëhet në Queen's Bench Division.

Këshilltari juaj ligjor mund t'ju japë më shumë informacion rreth këtyre çështjeve.

Në disa rrethana të caktuara mund të ekzistojnë të drejta të tjera për apel dhe këshilloheni të flisni me këshilltarin tuaj ligjor.

Për ndihmë me gjetjen e një përfaqësuesi ligjor ju lutemi kontaktoni:

**Asylum Advice UK - 0808 8000 620**

**[www.asylumhelpuk.org](http://www.asylumhelpuk.org)**

**Ju lutemi të vini re se ne nuk mundemi t'ju ndihmojmë me çështjet e emigracionit.**

## **4B.8 Çfarë ndodh pas apelit tim?**

Marrja e një vendimi pozitiv - Nëse merrni një përcaktim pozitiv dhe çështja juaj lejohet e Home Office nuk e apelon, atëherë duhet të merrni konfirmimin nga Home Office se do t'ju jepet 'Leje qëndrimi' në Mbretërinë e Bashkuar. (Ju lutemi lexoni pjesën për grantet pas vendimit.)

Një apel tjetër - nëse ju ose Home Office apelonit vendimin dhe ju jepet leja për të apeluar, gjykata do të organizojë një seancë dëgjimore për rishqyrtim. Ju do të vazhdoni të jeni azilkërkues ndërkohë që prisni që gjykata të marrë një vendim tjetër. Kjo ose do të pranohet ose do të refuzohet pasi të jetë dëgjuar çështja juaj.

Nuk lejohen apele të mëtejshme – Nëse, pas përcaktimit të gjykatës nuk ka arsye për apel, ose leja e mëtejshme refuzohet atëherë të "Drejtat tuaja për apel janë konsumuar". Kjo do të thotë se nuk jeni më azilkërkues për shkak se kërkesa juaj për azil ka dështuar.

Nëse nuk keni apele në vijim Home Office pret që ju të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar:

Home Office pret që ju të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar nëse ju:

- është refuzuar azili dhe nuk ju është dhënë leje;
- keni arritur në fund të procesit të apelit; ose
- tërhiqni aplikimin tuaj për azil.

## 4B.9 Nëse zgjedh të largohem nga Mbretëria e Bashkuar me dëshirë?

Ka dy opsione për t'ju ndihmuar nëse zgjidhni të ktheheni në atdhe.

- 1) Mund të aplikoni për Kthimin Vullnetar të Asistuar (AVR) nëpërmjet Home Office, për informacione të mëtejshme se si kontaktohen ata ju lutemi vizitoni tek: [www.gov.uk/return-home-voluntarily](http://www.gov.uk/return-home-voluntarily)
- 2) Mund ta organizoni vetë udhëtimin. Ju duhet të kontaktoni Home Office përpara se të rezervoni udhëtimin, në mënyrë që të organizoni marrjen e pasaportës tuaj, dokumenteve të udhëtimit dhe çdo dokument tjetër përkatës përpara nisjes.

## 4B.10 Çfarë është AVR?

Programi i Kthimit Vullnetar të Asistuar (AVR) menaxhohet nga Home Office. Mund t'ju ndihmojë të ktheheni në vendin tuaj të origjinës ose një vend tjetër nëse mund të provoni se keni të drejtën të jetoni aty. Për informacin të mëtejshëm ju lutemi vizitoni: [www.gov.uk/return-home-voluntarily](http://www.gov.uk/return-home-voluntarily) Departamenti i nisjes vullnetare: 0300 004 0202

## 4B.11 Çfarë ndodh nëse ka fëmijë në familjen time?

Home Office do të punojë me ju dhe familjen tuaj për të diskutuar opsionet. Ata do të marrin parasysh opsionet në vijim:

Për informacion të mëtejshëm kontaktoni: [www.gov.uk/return-home-voluntarily](http://www.gov.uk/return-home-voluntarily)

Departamenti i nisjes vullnetare: 0300 004 0202

### **Kthimi i kërkuar**

Nëse zgjidhni të mos largoheni me dëshirë nga Mbretëria e Bashkuar, Home Office do t'ju shkruajë për t'ju thënë se kërkon që të largoheni. Do të merrni një paralajmërim dy javor për kthimin dhe duhet që ju dhe fëmijët tuaj të jeni plotësisht të përgatitur. Ka të ngjarë që të keni opsionin që ta menaxhoni vetë kthimin tuaj.

## **Kthimi i siguruar**

Kthimi i siguruar përdoret kur opsionet e tjera që ju të ktheheni në atdheun tuaj kanë dështuar. Çështja juaj do të rishikohet nga një panel i pavarur i kthimeve të familjeve, nëse ju kaloni në fazën e kthimit të siguruar. Paneli do të këshillojë metodën më të përshtatshme për kthimin, bazuar mbi sigurinë e fëmijëve.

Home Office ka një qendër akomodimi për familjet para nisjes. Kjo quhet Cedars dhe është afër aeroportit Gatwick. Paneli i kthimeve të familjeve mund të vendosë se të gjitha opsionet e kthimit janë përdorur ose janë të papërshtatshme.

## **4B.12 Çfarë ndodh nëse nuk dua të kthehem?**

Nëse zgjidhni të mos i përdorni shërbimet për t'ju ndihmuar të ktheheni ose nuk bëni përpjekje për tu larguar nga Mbretëria e Bashkuar, atëherë Home Office do të ndërmarrë veprime detyruese për t'ju larguar. Kjo do të thotë se do të detyroheni të ktheheni në vendin tuaj të origjinës.

Nëse Home Office mendon t'ju largojë nga Mbretëria e Bashkuar, çështja juaj do të transferohet nga UK Visa and Immigration Department tek Home Office Immigration Enforcement.

Immigration Enforcement do t'ju japë njoftim me shkrim nëse synojnë t'ju largojnë nga Mbretëria e Bashkuar dhe do t'ju njoftojnë për të drejtën e apelit ndaj këtij vendimi. Atyre ju duhet të ndjekin një proces ligjor që i mundëson t'ju detyrojnë ju të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar nëse të drejtat tuaja për apel janë përfunduar dhe nuk keni më të drejta ligjore për të qëndruar këtu. Kjo mund të përfshijë arrestimin dhe ndalimin në një qendër të sigurt derisa të largoheni nga vendi. Për ndryshe Detyrimi i Imigracionit mundet t'ju kërkojë thjesht që të raportoni në një vend të caktuar në një kohë të caktuar ndërkohë që organizohet largimi juaj. Home Office mund t'ju ndalojë pa paralajmërim ndërkohë që organizon largimin tuaj.

## **4B.13 Rrethanat për ndalimin**

Home Office do të shikojë faktorët në vijim për të vendosur nëse duhet t'ju vendosë në ndalim. Këto janë:

- historia juaj e mëparshme e imigracionit
- vendi juaj i origjinës
- nëse e keni zbatuar pranimin tuaj të përkohshëm (keni raportuar në pajtim me formularin tuaj IS96?)
- gjasat se mund të largoheni.



## 4B.14 Çfarë ndodh nëse mendoj se jam në rrezik po të kthehem?

Nëse çështja juaj për azil është përcaktuar plotësisht dhe keni dalë pa sukses, është e rëndësishme që të kërkonit këshilla ligjore për të parë nëse ka opsione të tjera për ju dhe nëse ka ndonjë parashtrim të mëtejshëm që mund të përdoret në çështjen tuaj.

Ju duhet të pyesni këshilltarin tuaj ligjor për këtë. Ata duhet t'ju shpjegojnë gjithë opsionet e tjera kur ta mbyllin çështjen tuaj.

Ju mund të keni mundësinë të paraqisni një kërkesë të re për azil te Home Office. Për ta bërë këtë ju duhet të keni prova të mëtejshme për të paraqitur te Home Office. Paraqitja do të konsiderohet si kërkesë e re nëse është shumë e ndryshme nga materiali që është shqyrtuar më parë. Parashtrimet do të jenë të ndryshme në mënyrë të konsiderueshme vetëm nëse përmbajtja:

- (i) nuk është shqyrtuar akoma; dhe
- (ii) së bashku me materialin e shqyrtuar më parë, krijon një prospekt real suksesi, pavarësisht nga refuzimi.

## 4B.15 Çfarë do të ndodhë me mbështetjen time nëse bëhem një azilkërkuar i refuzuar?

Nëse azili juaj është refuzuar plotësisht, nuk keni persona që varen nga ju nën moshën 18 vjeç dhe të drejtat tuaja për apel janë përfunduar ose zgjidhni ta tërhiqni kërkesën tuaj për azil, ju do ta humbni të drejtën tuaj për mbështetje 21 ditë pasi kërkesa juaj të jetë përcaktuar plotësisht. Do të merrni një letër nga Home Office dhe do t'ju jepen 7 ditë njoftim që të largoheni nga prona nëse jeni në akomodim të Home Office.

Nëse keni persona që varen nga ju në shtëpi të cilët janë nën moshën 18 vjeç, mbështetja e Home Office do të vazhdojë derisa ju dhe familja juaj ose të ktheheni vullnetarisht, ose të largoheni, ose derisa personat e varur nga ju të mbushin 18 vjeç.

## 4B.16 Mbështetja në zbatim të Pjesës 4

Mbështetje afatshkurtër nëse aplikimi juaj ka qenë i pasuksesshëm.

Nëse mbështetja juaj është përfunduar mund të kualifikoheni për mbështetje afatshkurtër ndërkohë që përgatiteni të ktheheni në vendin tuaj. Kjo njihet si “mbështetja nën nenin 4” për shkak se jepet në zbatim të kushteve të pjesës 4 të Ligjit për Imigracionin dhe Azilin të vitit 1999. Mbështetja nën Pjesën 4 është për azilkërkuarët që janë refuzuar. Mbështetja nën Pjesën 4 është e ndryshme nga

mbështetja që mund të keni marrë gjatë kërkesës tuaj për azil (Mbështetja nën Pjesën 95) për shkak të arsyeve të mëposhtme:

- Nuk keni të drejtë të merrni të holla. Mbështetja do të jepet në formën e një karte pagese. Kjo kartë njihet si karta 'Azure'. Ajo mund të përdoret vetëm në disa dyqane në Mbretërinë e Bashkuar - Tesco, Sainsbury, The Co-Operative, Morrisons, Peacocks, Early Learning Centre, Asda, Mothercare, The Red Cross dhe The Salvation Army.

Ju duhet të plotësoni kërkesat që të kualifikoni për mbështetjen nën pjesën 4. Ju duhet të jeni i varfër dhe të plotësoni një nga kërkesat në vijim:

- 1) ju po ndërmerrni TË GJITHA HAPAT E ARSYESHME për t'u larguar nga Mbretëria e Bashkuar ose po e vendosni veten në një pozicion ku mund ta bëni këtë; ose
- 2) ju ose pjesëtarët e familjes tuaj nuk mund të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar për shkak të pengesave fizike për të udhëtuar ose për disa arsye të tjera mjekësore; ose
- 3) nuk mund të largoheni nga Mbretëria e Bashkuar sepse, sipas mendimit të Sekretarit të Shtetit, nuk ka rrugë të përshtatshme kthimi të disponueshme për momentin; ose
- 4) keni aplikuar për një rishikim gjyqësor të aplikimit tuaj për azil dhe ju është dhënë leja për të vazhduar me të; ose
- 5) akomodimi është i nevojshëm që të parandalohet një shkelje e të drejtave tuaja brenda kuptimit të Ligjit për të Drejtat e Njeriut të vitit 1998.

## **1. Të gjitha hapat e arsyeshme**

Që të kualifikoheni për mbështetjen e pjesës 4 nën këtë kusht, duhet që të tregoni se po ndërmerrni të gjitha hapat e arsyeshme për t'u larguar nga Mbretëria e Bashkuar. Home Office mund t'ju refuzojë mbështetjen nëse mendon se nuk po i ndiqni të gjitha opsionet që keni. Për të përcaktuar se një hap i veçantë është 'i arsyeshëm' kjo do të varet nga rrethanat tuaja. Zakonisht do të pritët që ju të aplikoni për kthimin vullnetar me programin e Home Office dhe të viheni në kontakt me ambasadën e shtetit tuaj me qëllim që të paiseni me një pasaportë emergjente (nëse kjo ju nevojitet).

**Shënim i rëndësishëm: Nëse mendoni se mund të keni arsye për të paraqitur një kërkesë të re është e rëndësishme që të kërkonti këshilla ligjore. Çdo aplikim për kthim vullnetar edhe nëse tërhiqet mund të ndikojë mbi kërkesën e re.**

## **2. Pengesa fizike për të udhëtuar**

Që të kualifikoheni nën këtë kusht duhet të mos jeni në gjendje të udhëtoni për shkak të një problemi mjekësor. Ju duhet t'i provoni Home Office se ju ose një pjesëtar i

familjes nuk mund të udhëtojë për shkak të një problemi të shëndetit fizik ose mendor. Nuk është e mjaftueshme që të tregoni se po merrni trajtim mjekësor në Mbretërinë e Bashkuar ose se mjeku juaj mendon se do të preferohej që ju të mos udhëtonit. Duhet të keni një problem mjekësor që ju bën ju ose familjen tuaj të PAMUNDUR që të udhëtoni.

### **Evidenca që kërkohet për të provuar ‘pengesën fizike për të udhëtuar’:**

- Dokumentet me shkrim duhet të jenë marrë nga një mjek e të përcaktojnë në mënyrë specifike se NUK MUND të udhëtoni, arsytet për këtë dhe për sa kohë nuk do të jeni në gjendje që të udhëtoni.
- Ju duhet t’i kërkoni mjekut tuaj të plotësojë një formular të “Deklaratës Mjekësore të Nenit 4” që gjendet në faqen e internetit Gov.uk ose kontaktoni Asylum Help në 0808 8000 620 që ata t’ju a dërgojnë këtë formular.

### **Shtatzënia dhe pengesa fizike për të udhëtuar**

Politika e Home Office është që gratë në fazat e vona të shtatzënisë (rreth gjashtë javë përpara datës së llogaritur të lindjes, ose më parë nëse kanë ndërlikime), ose gratë me foshnja nën gjashtë javë, automatikisht pranohen si persona që nuk mund të udhëtojnë.

Provat për shtatzëninë duhen paraqitur në formën e certifikatës së maternitetit, certifikatës së lindjes dhe deklaratës mjekësore nëse po aplikoni përpara gjashtë javëve nga data kur priteni të lindni.

### **3. Nuk ka rrugë të përshtatshme për t’u kthyer**

Kjo kërkesë aplikohet për persona që nuk mund të largohen nga Mbretëria e Bashkuar pasi sipas mendimit të Sekretarit të Shtetit nuk ka një rrugë të përshtatshme kthimi.

### **4. Aplikimi për rishikim gjyqësor**

Nëse këshilltari juaj ligjor ka paraqitur një rishikim gjyqësor në lidhje me një vendim mbi kërkesën tuaj për azil, ata duhet që së pari të aplikojnë te Gjykata e Lartë për leje që ta bëjnë këtë. Pasi Gjykata e Lartë t’ju ketë dhënë lejen, ju do të kualifikoheni për mbështetje nën nenin 4 sipas këtij kushti. Nëse jetoni në Skoci dhe keni paraqitur kërkesën në Gjykatën e Seancave atëherë ju mund të aplikoni sipas këtij neni.

### **Evidenca që kërkohet për të provuar ‘aplikimin për rishikimin gjyqësor’:**

Një letër nga Gjykata e Lartë që konfirmon lejen për të vazhduar. Konfirmim që kërkesa është paraqitur (Skoci).

## 5. Shkelja e të drejtave të njeriut

Home Office nuk mund t'ju heqë mbështetjen nëse po ta bëjë këtë do të shkaktojë një shkelje të së drejtave të njeriut.

Edhe pse varfëria në disa raste është konsideruar si një shkelje e të drejtave të njeriut, një azilkërkues që ka dështuar e që nuk mendohet se po i bën të gjitha përpjekjet për t'u larguar nga Mbretëria e Bashkuar nuk e ka të drejtën të mbështetet. Kjo për shkak se Gjykatat kanë vendosur se e kanë shkaktuar vetë varfërinë dhe për këtë arsye nuk kanë të drejtën e mbështetjes. Home Office duhet të ofrojë mbështetje nëse të drejtat tuaja nën Konventën Evropiane të së Drejtave të Njeriut do të shkeleshin nëse mbështetja ju ndërpritet.

Për shembull nëse keni bërë një kërkesë të re për azil, e cila është ende në shqyrtim, ju mund të aplikoni në zbatim të kësaj pjese. Kjo mund të ndodhë edhe në rastin kur është paraqitur një rishikim gjyqësor, por leja për të vazhduar nuk është dhënë akoma. Mund të aplikoni në zbatim të kësaj pjese nëse familja juaj do të ndahet sepse disa prej pjesëtarëve ju është ndërprerë mbështetja. Nëse ju keni një kërkesë të bazuar ne mos-mbrojtje nën shqyrtim nga Home Office, atëherë ju nuk do të keni të drejtën e mbështetjes. Kjo nuk do të konsiderohet si një pengesë për tu larguar nga Mbretëria e Bashkuar për të shmangur efektet e mjerimit.

**Përfaqësuesi ligjor duhet të jetë në gjendje t'ju ndihmojë në qoftë se ju keni evidencë të reja në dispozicion me shkaqet se pse ju nuk mund të ktheheni në nendin tuaj. Evidenca që kërkohet për të provuar 'shkeljen e të drejtave të njeriut' përfshin:**

- Konfirmimin se është paraqitur një kërkesë e re
- Certifikatat e lindjes, provë për jetën familjare
- Kopje të parashtrimeve të Gjykata e Lartë

Nëse keni nevojë për më shumë këshilla në lidhje me nenin 4 ose ndihmë për gjetjen e një përfaqësuesi ligjor, ju lutem kontaktoni Asylum Help në numrin: 0808 8000 620.

## 4B.17 Çfarë duhet të bëj për të provuar se jam i skamur?

The Home Office do t'ju konsiderojë se jeni të skamur nëse nuk keni 'akomodim të përshtatshëm' ose nuk keni mënyra për të plotësuar 'nevojat thelbësore të jetesës' (të tilla si aksesit tek ushqimi, ndriçimi dhe ngrohja) tani ose për 14 ditët e ardhshme.

Ju duhet të demonstroi se jeni ose rrezikoni që të bëheni "të pastrehë që jetojnë në rrugë". Është e mjaftueshme të paraqisni evidencë se nuk do të keni akomodim të përshtatshëm ose se nuk do të mund të plotësoni nevojat bazë të jetesës për 14 ditët e ardhshme.

## Kontrolle mjerimi do të bëhen ende që mund të rezultojë në kërkesa të mëtejshme për informacione nga aplikuesi.

### Evidenca që kërkohet për të provuar 'skamjen':

- Duhet të paraqisni një listë adresash në të cilat keni jetuar që kur ju është ndaluar mbështetja, plus detajet se sa gjatë keni qëndruar në secilën adresë dhe përse kjo mbështetje nuk mund të vazhdojë më.
- Evidenca rreth akomodimit tuaj më të fundit, në ç'vend ka qenë dhe përse ky akomodim nuk ju ofrohet më (letër nga një mik ose i afërt që duhet të përfshijë 6 muajt e fundit).
- Njoftimi për nxjerrjen jashtë, etj.
- Evidencë nga çdo mbështetje bamirësie që keni marrë ose përpjekje për të kërkuar mbështetje bamirësie.
- Kopje të gjithë pasqyrave bankare (nëse ka) për 6 muajt e fundit.
- Nëse jeni prind i vetëm mund t'ju kërkohet evidencë për përpjekjet që keni bërë për të marrë mbështetje financiare nga babai i fëmijës.
- Nëse më parë keni pasur leje për të punuar ose keni punuar në mënyrë të paligjshme, mund t'ju kërkohet formulari juaj më i fundit P60 dhe/ose faturat e pagesës, plus evidencë se nuk po punoni më ose nuk e keni të drejtën të punoni më.
- Nëse jetoni në akomodim privat me qira, marrëveshjen e qirasë dhe çdo kërkesë tjetër për t'u larguar nga prona.
- Nëse më parë keni marrë ndihma financiare të zakonshme, prova se nuk e keni më këtë të drejtë (p.sh. letër nga DWP).
- Mund të jetë e dobishme që të përgatisni edhe një deklaratë personale rreth mënyrës se si keni mbijetuar që kur ju është ndërprerë mbështetja juaj e mëparshme. Kjo mund të jenë të rëndësishme për persona që kanë vështirësi të marrin informacionin e kërkuar.

## 4B.18 Si të aplikoj për Mbështetjen nën Pjesën 4?

Nëse ju nevojitet informacion dhe këshilla të mëtejshme mbi Mbështetjen nën Pjesën 4 (përfshi përshtatshmërinë) atëherë duhet të kontaktoni Asylum Advice UK në 0800 8000 620 ose vizitoni [www.asylumhelpuk.org](http://www.asylumhelpuk.org).

Nëse e keni vendosur se do të aplikoni për mbështetje nën Nenin 4 dhe ju nevojitet ndihmë për të plotësuar formularin e aplikimit, duhet të kontaktoni Asylum Help: Asylum Support Application UK në [www.asylumhelpuk.org](http://www.asylumhelpuk.org) ose Asylum Support

Application UK në numrin 0808 8000 621.

Ju duhet të keni gati të gjitha provat e duhura për të aplikuar për mbështetje.

**Nuk do të kualifikoheni për mbështetje derisa Home Office ta ketë shqyrtuar aplikimin tuaj.**

Asylum Help mund t'ju ndihmojnë me aplikimin tuaj për mbështetje, por ju do të duhet të paraqisni dëshmi të mjerimit dhe konfirmimin se si ju i përmbushni kriteret e mësipërme.

Asylum Help do të shqyrtojnë rrethanat tuaja personale dhe do konfirmojnë evidencat që Home Office do të kërkojë për të vlerësuar të drejtën tuaj për mbështetje. Pasi ti kemi marrë këto ne mund t'ju ndihmojnë me kërkesën tuaj për mbështetje. Në qoftë se Home Office nuk mendon se keni vertetur se ju jeni i mjeruar apo ju nuk i përmbushni kriteret ata ose do të refuzojë kërkesën tuaj ose të kërkojnë dokumente të mëtejshme.

Në qoftë se ju nuk do të ofrojë dëshmi siç kërkohet nga Home Office aplikimi juaj mund të mbyllet pa marrë asnjë veprim të mëtejshëm.

## 4B.19 Apeli për mbështetjen në zbatim të Pjesës 4

Nëse aplikimi juaj për Pjesën 4 refuzohet atëherë ekziston e drejta për të apeluar në First-tier Tribunal (Mbështetja për Azil). Home Office do t'ju dërgojë një letër që e ka refuzuar mbështetjen. Kjo letër do të përcaktojë bazat apo arsyet për refuzimin. Apelet duhet të paraqiten brenda tre ditësh pune nga data e vendimit. Ju duhet të kontaktoni Asylum Help sa më parë që të jetë e mundur për ndihmë me apelin. Asylum Help do të konfirmoj nëse keni arsye për të apeluar dhe do t'ju shpjegojë opsionet tuaja.

Për informacione të metejshme vizitoni faqen e internetit të Asylum Support Appeals Project: [www.asaproject.org](http://www.asaproject.org).

## 4B.20 Ndryshimi i rrethanave

Është e rëndësishme që të njoftoni Home Office, gjykatat dhe këshilltarin tuaj ligjor (nëse keni një të tillë) për rrethanat tuaja. Kjo mund të ndikojë mbi çështjen tuaj. Nëse nuk i njoftoni për ndryshimin e adresës mund të mos merrni letra të rëndësishme nga gjykata. Nëse ju lind një fëmijë dhe nuk i njoftoni atëherë fëmija nuk do të shtohet në aplikimin tuaj për azil. Home Office duhet njoftuar për secilin ndryshim në vijim:

- ndryshimin e emrit tuaj;
- nëse çdonjëri prej personave që varet nga ju ka mbushur 18 vjeç;

- transferimi në një banesë tjetër;
- martoheni, shkurorezoheni ose ndaheni nga partneri juaj;
- shtroheni në spital;
- ju, ose partnerja juaj mbeteni shtatzënë ose ju lind një fëmijë;
- ndonjë prej fëmijëve tuaj mbaron shkollën ose largohet nga shtëpia;
- çdo pjesëtar tjetër të familjes që ju vjen ose largohet nga Mbretëria e Bashkuar;
- gjithë të tjerët që vijnë për të jetuar me ju ose largohen nga akomodimi;
- ju futeni në burg;
- merrni ose fitoni akses te para për të cilat nuk na keni thënë më parë;
- merrni ose fitoni akses te para pasi keni shitur diçka; ose
- nuk doni më që t'ju ofrojmë akomodim.

Ç'ka më sipër mund të ketë pasoja mbi mbështetjen tuaj për azil ose duhet t'i thuhet gjykatës/këshilltarit tuaj ligjor. Asylum Help mund të ju ndihmojë për të informuar repartin e mbetshetjes së azilit tek Home Office të një ndryshimi në rrethanat e mësipërme. Megjithatë, është e rëndësishme që ju të njoftoni edhe repartin e emigracionit tek Home Office/Courts për këto ndryshime. Përfaqësuesi juaj ligjor duhet të jetë në gjendje t'ju ndihmojë me këtë.

**Për informacion të mëtejshëm në lidhje me çështjet e mbështetjes së azilantit ose sigurimin e këshillave ligjore, ju lutemi kontaktoni Asylum Help në:**

**[www.asylumhelpuk.org](http://www.asylumhelpuk.org);**

**Asylum Advice UK në numrin 0808 8000 620;**

**ose Asylum Support Application UK në numrin 0808 8000 621**